



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
Prishtinë / Priština



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.02.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. SUZANA SYLA** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Rrezarta Krasniqi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Suzana Syla dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 22.01.2020, Nr.56/2020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Rrezarta Krasniqi, pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidatja e radhës në listën e rirenditur është, znj. Suzana Syla e cila ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 07.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Prishtinë
Republika e Kosovës